



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli Kombetar i Ujit

VENDIM

Nr. 4 , date 7.6.2007

PER

KRYERJEN E STUDIMIT PER SHPIMET PER UJE, TE PIJSEM DHE
TEKNOLOGJIK, NE AKSIN TIRANE-DURRES

Në mbështetje të shkronjes “a”, të pikës 1, të nenit 6, të ligjit nr. 8093, datë 21.3.1996, “Për rezervat ujore”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave Këshilli Kombetar i Ujit

VENDOSI:

- 1.Kryerjen e studimit, me temë “Evidentimi i punimeve të shpimeve për ujë, të pijshëm dhe teknologjik, në aksin Tirane-Durrës”.
- 2.Sherbimi Gjeologjik Shqiptar të përcaktojë termat e referencës brenda një muaji nga miratimi i këtij vendimi.
3. Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Ishem-Erzen të miratojë studimin, brenda 4 muajve nga miratimi i fondit për kryerjen e studimit.
4. Ngarkohen ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujerave dhe ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të paraqesin për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave projektvendimin për mbështetjen e këtij studimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Lufter XHUVI

Zv/Kryetari K.K.U
dhe

Minister i Mjedisit, Pyjeve dhe
Administrimit të Ujerave



Sali BERISHA

